Kronikë

Tritol në makinë, plagoset vëllai i kreut të bandës së Mirditës! Prej 20 vitesh asnjë gjurmë prej tij, në 2000 u dënua përjetë për vrasjen e një polici

Një 47-vjeçar në Mirditë mbeti i plagosur, pasi u sulmua me lëndë plasëse. Ngjarja ndodhi mëngjesin e së dielës ne fshatin Malaj, ndërsa në shënjestër ishte Lodovik Syziu 47-vjeç, vëllai i kreut të bandës së Mirditës, Dritan Syziu. Lënda plasëse ishte vendosur në pjesën e pasme të automjetit.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GenBuffo

Redaksia
30 Qershor, 10:07 | **Përditësimi: 30 Qershor, 15:41**

Share

MIRDITË- Një 47-vjeçar në Mirditë mbeti i plagosur, pasi u sulmua me lëndë plasëse. Ngjarja ndodhi mëngjesin e së dielës ne fshatin Malaj, ndërsa në shënjestër ishte Lodovik Syziu 47-vjeç, vëllai i kreut të bandës së Mirditës, Dritan Syziu. Lënda plasëse ishte vendosur në pjesën e pasme të automjetit të parkuar pranë banesës së 47-vjeçarit dhe shpërtheu sapo ky i fundit ndezi makinën.

Nga shpërthimi Lodovik Syziu mori fraktura në disa pjesë të trupit dhe u dërgua me urgjencë për ndihmë mjekësore në Spitalin e Rrëshenit, nga ku mësohet se ndodhet nën kujdesin e bluzave të bardha jashtë rrezikut për jetën. Autorët dhe motivet e ngjarjes ende nuk dihen, por policia po heton në dy pista, të shkuarën kriminale të vëllait, por edhe ndonjë konflikt të 47-vjeçarit me banorë të zonës.

Në dëshminë e parë të dhënë pasi ka marrë ndihmën mjekësore, Ledovik Syziu ka deklaruar se nuk ka asnjë dijeni për autoret apo shkaqet, por ndërkohë janë thirrur për t'u marrë në pyetje edhe familjarë të tij me qëllimin për të mësuar për ndonjë incident që mund të ketë patur i plagosuri.

LEXO EDHE:
Shoqëroi Ervis Martinajn dhe ishte kontakti i fundit para zhdukjes! Prokuroria bën rekurs në Gjykatën e Lartë dënimin me 2 vite e 10 muaj burg të Jeton Lamit

Kush është Dritan Syziu?

Dritan Syziu, njihej ndryshe edhe si kreu i bandës së Mirditës I dyshuar si autor i disa ngjarjeve në Mirditë në vitin 1997, ndërsa prej tij prej gati rreth 20 vitesh nuk ka asnjë gjurmë. Syziu është dënuar me burgim të përjetshëm pasi për një ngjarje që ka ndodhur më 28 qershor të vitit 2000, ku mbeti i vrarë punonjësi i policisë, Gjon Paçuku. Këtë vrasje ai e ka kryer në bashkëpunim me 5 persona të tjerë.

Vrasja

Ishin orët e para të mëngjesit të 28 qershorit të vitit 2000 kur 6 të pandehurit e bandës së Mirditës, Dritan Syziu, Nikollë Syziu, Bardhok Syziu, Tonin Gjoka e Arjan Reçi vendosën që të grabisnin disa pjesë këmbimi për makina të njëi parkingu pranë ish-SMT-së së qytetit. Autorët pikasen nga roja dhe ky i fundit njofton Policinë. Menjëherë në vendngjarje erdhën efektivat e policisë, të cilët mendonin se kishin të bënin me një vjedhje modeste. Pasi kanë parkuar makinën jashtë ish-SMT-së, u kanë kërkuar anëtarëve të bandës që të dorëzohen. Por autorët kanë qëlluar me armë në drejtim të Policëve dhe aty mbeti i vrarë efektivi Gjon Pacuku dhe u plagosën Nikollë Marku, Bardhosh Jaku e Ndue Çupi.

Lodovik Syziu dhe kreu i bandës së Mirditës, Dritan Syziu

SI.E./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Gjon Paçuku | Lodovik Syziu | dritan syziu | mirditë | Lezhë

Komento

Ndalohet reprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH ZONE

Sondazhi i ditës:
Censi 2023, popullsia u tkurr me 419 mijë në 12 vite, cili është shkaku?

Emigrimi | Lindshmëria | Vdekshmëria

Lajme të tjera

Marrëveshja me Italinë/ Gati qendrat në Shëngjin, emigrantët e parë mbërrijnë nga 1 gushti

28 Qershor, 18:23

Shitja e 'çmendur' e apartamenteve në bregdet, çerekun e Shëngjinit e kanë blerë të huajt!

Elvis Hila

28 Qershor, 17:20

Pse mbahet i fshehtë projekti për restaurimin e Urës së Zogut? Shoqëria civile kërkon transparencë nga 'Kultura'

Elvis Hila

27 Qershor, 14:37

Pas të nxehtit përvëlues, vendi përfshihet nga reshje shiu! Në Lezhë përmbyten rrugët

27 Qershor, 08:10

Lezhë/ Vihet në pranga 37 vjeçari, dhunonte bashkëjetuesen! Në banesë iu gjetën armë dhe municione (EMRI)

26 Qershor, 12:16

Vranë biznesmenin Rakip Roli në 2021, Gjykata e Lezhës dënon me 47 vite burg dy autorët

Elvis Hila

26 Qershor, 08:43

Plagosën 54 vjeçarin në Mirditë, në pranga 3 vëllezër (EMRAT)

25 Qershor, 12:05

Në 2015 vrau 16-vjeçarin për t'i grabitur Rolex-in dhe varësen e floririt, Prokuroria e Lezhës kërkon burg përjetë për Kristian Cenajn

Elvis Hila

25 Qershor, 08:16

Megaoperacioni 'Territor i pastër'/ Policia gjen dhe asgjësën 5396 fidanë dhe bimë kanabis në qarqet Lezhë, Elbasan dhe Shkodër

24 Qershor, 10:59

Vdes në Shëngjin gazetari Isuf Kadriu! Korrespodenti i Evropa e Lirë në Shkup pësoi atak kardiak

23 Qershor, 20:07

"Krejt kjo bukuri pa energji elektrike!" Pushime pa drita në Kune, uji i ftohtë "luks"

Elvis Hila

22 Qershor, 15:36

Drejtuesi i motorit humb kontrollin dhe përplaset me murin në aksin Lezhë-Shëngjin, dërgohet në spital (VIDEO)

22 Qershor, 10:10

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje